



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:122009

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06546728

C.nr.885/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alush Sinani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.R.nga K., kundër të paditurit S.J.n ish nga K., tani me vendbanim te panjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, me vler kontesti 3,200.00 euro me datë 04.12.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit D.R.nga K., kundër të paditurit S.J.n ish nga K., tani me vendbanim te panjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë vlera e kontestit 3,200.00 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Arsyetim

Me datë 28.09.2020, paditësi D.R.nga K., përmes të autprizuarit të tij I.S.avokat në Viti, ka paraqitur padi kundër të paditurit S.J.n ish nga K., tani me vendbanim te panjohur, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë. vlera e kontestit 3,200.00 euro.

Gjykata me datë 15.06.2024, ka pranuar parashtresen nga paditësi, me të cilën ka njoftuar gjykatën se ka revokuar autorizimin e dhenë I.S.avokat në Viti, për përfaqsimin e lëndes Cnr 885/2020.

Gjykata, me Aktvendimin Cnr, 885/2020, te datës 19.08.2024, paditësit ia ka kthyer në plotësim padinë, duke e udhëzuar qartë në plotësimin e padisë me prova-Certifikaten e pronësisë për parcelen nr,P-73701026001685-0, brenda afatit ligjor prej 3 ditësh, sipas nenit 102.1 të LPK-së, e po ashtu, e ka paralajmëruar me pasojat ligjore në rast të dështimit për të vepruar brenda afatit.

Pas shikimit të shkresave të lëndës, gjykata ka gjetur se paditësi nuk kanë vepruar brenda afatit ligjor, përkundër se Aktvendimin Cnr, 885/2020, te datës 19.08.2024, personaisht paditësi e ka pranuar më datë 16.10.2024.

Pasi u vërtetua se paditësi nuk ka vepruar brenda afatit ligjor, gjykata, duke u mbështetur në nenin 102 pika 3, të LPK-së, sipas të cilit: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*, lidhur me nenin lidhur me nenin 142 pika 1 e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:122009, 04.12.2024
C.nr.885/2020**

Gjyqtari,
Alush Sinani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë Gjykatë